

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Aparatura per Okulistike dhe poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise” I ndare ne dy lote perkatesisht

Lot. 1 “Aparatura per okulistike”

Lot. 2 “ Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

33100000-1 - Pajisje mjekësore, 33124100-6 - Pajisje diagnostike, 33190000-8 - Pajisje dhe produkte të ndryshme mjekësore

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-80769-09-21-2023

Lot. 1 “Aparatura per okulistike” : REF-80777-09-21-2023

Lot. 2 “ Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise” : REF-80785-09-21-2023

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit total per te dy lotet : 17 912 333 (shtatembedhjete million e nenteqind e dymbedhjete mije e treqind e tridhjetë e tre) leke **pa TVSH perkatesisht :**

Fondi Limit per Lot. 1 “Aparatura per okulistike” : 10 520 000 (dhjete milion e pesëqind e njetete mije) lekë pa TVSH;

Fondi limit per Lot. 2 “ Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise” : 7 392 333 (shtate milion e treqind e nentehjete e dy mije e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

Burimi i Financimit : Te ardhurat dytesore per perdorimin e te cilave eshte marre miratim nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per LOT 1 me shkrese nr.17/46.prot date 13.02.2023 “Miratim shpenzimesh nga te ardhurat dytesore per vitin 2023” administruar prane Spitalit Rajonal Fier me nr.685, date 15.02.2023 dhe per LOT 2 me shkrese nr.17/47.prot date 13.02.2023 “Miratim shpenzimesh nga te ardhurat dytesore per vitin 2023” administruar prane Spitalit rajonal Fier me nr.686, date 15.02.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekti i kontrates

“Aparatura per Okulistike dhe poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise” i ndare ne dy lote perkatesisht :

- Lot. 1 “Aparatura per okulistike”

- Lot. 2 “ Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”

Kontrata eshte ndare ne dy lote konform të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke marre parasysh natyren e mallrave (aparaturave) dhe shërbimet per te cilat ato kerkohen

TE NJEJTA PER TE DY LOTET

1- Kriteri i përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Operatori ekonomik, në plotësimin e formularit të ofertës duhet t’i referohet Fondit Limit Kontratës. Tejkalmimi mbi fondin e përcaktuar të Kontratës është kusht skualifikues.

Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar bazuar në nenin 87, pika 1, 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 45 pika 1,2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Fondit limit total per te dy lotet : 17 912 333 (shtatembdhjete million e nenteqind e dymbjedhete mije e treqind e tridhjetë e tre) leke **pa TVSH**

Fondi limit eshte perlllogaritur bazuar ne V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 76 nen titullin “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

germa b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

referuar ne rastin konkret Autoriteti Kontraktor ne perlllogaritjen e fondit limit eshte bazuar cmimet e tregut pasqyruar ne process verbalin nr.6401.prot date 14.12.2022 dhe 4177.prot date 30.08.2022 te Grupit te punes per perlllogaritjen e fondit limit, process verbalin e komisionit te testimiut te tregut nr.5483/1.prot date 16.11.2022 dhe nr.4159.prot date 30.08.2022 si dhe bazuar ne kerkesen nr.1888.prot date 30.05.2023 te Pergjegjeses se Sektorit te Planifikimit dhe Prokurimit

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOT. 1 “APARATURA PER OKULISTIKE”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ,ne te cilen eshte e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

d. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2:

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të përllogaritur **të lotit ku ofertohe** / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin percaktohet se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;*

Ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik, nenit 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" pika 1 dhe pika 2 germa "b", parashikohet marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur ndërmjet kufirit te ulet dhe te larte monetar, konkretisht:

Ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku percaktohet se:

Neni 43 Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetare

Duke gene se kjo procedure prokurimi per kete lot eshte ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar bazuar ne vleren e fondit limit, AK ka marre parasysh praktikat e vendosur ndër vite te cilat kane rezultuar e suksesshme, lidhur me vendosjen e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik ne teresi. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrisë te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2022, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2023.*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurren.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kriterëve te mesiperm e ben oferten te vlefshme

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" nenit 77 pika 4 ku percaktohet se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,*

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar neni 40 pika 4 ku percaktohet se: 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77 dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 4 ku percaktohet se : 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **40 %** të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë ne përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura mjekesore te nje natyre te vecante

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te vetedeklaroje origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese ose distributorin e autorizuar. Te plotësohet ne shtojcën 2, Lista e cmimeve të artikujve ose te paraqese nje deklarate mbi origjinën e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjinës.).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura mjekesore specifike dhe te nje natyre te vecante.

2.3.3 Ofertuesi duhet te jete i certifikuar me certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te cilesise. Per kete ai duhet te paraqese certifikaten perkatese origjinale ose te perkthyer dhe te noterizuar. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku percaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise". Gjithashtu ISO 9001: 2015 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise , specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, për një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative). Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Ne rastin aktual është vendosur konform objektit të prokurimit.

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë Certificate CE ose FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të perkthyer dhe të noterizuara

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne funksion te cilesise së mallit te ofruar ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejmë te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit ; piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit; nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurimet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për garantimin e cilesise se mallit dhe për përmbushjen me sukses te kontrates . Gjithashtu ky kriter është vendosur për arsye se diaktiva CE ose FDA (SHBA) jep kërkesat thelbësore që janë të zbatueshme për instrumentet, aparateve dhe pajisjeve, materialeve ose artikujve të tjerë që përdoren nga njerëzit me qëllim percaktimin e Diagnozes, parandalimit, monitorimit, kurimit apo lehtësimit zbutjes së sëmundjes, Diagnozes, monitorimit, kurimit apo lehtësimit, zbutjes apo kompensimit për një lëndim apo difekt, Hulumtimin, zëvendësim apo modifikim të anatomisë apo të procesit fiziologjik ne funksion te dhenies se nje sherbimi sa me cilesor ne funksion te jetes se pacientit. Gjithashtu ky kriter është hartuar ne baze te rekomandimit te Njesise se monitorimit prane APP-se ne procedurat e mëparshme te kryera nga AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë "Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore", të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore". (Autorizimi duhet të jete I vlefshem).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet si dhe conform nenit 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”)

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e mallrave ose nga Distributori i Autorizuar nga prodhuesi (distributori duhet të jetë i autorizuar për territorin e Shqipërisë) lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi, pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me aparaturë specifike të një natyre të vecante. Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatorin ekonomik ofertues.

2.3.7 Deklarate për përmbushjen e afatit të garancisë. Garancia jo më e vogël se një vit ku përfshihet mirembajtja, zëvendësimi i aparaturore/pajisjes ose i pjesëve të defektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale të cilat do të sigurohen operatorin ekonomik fitues me shpenzimet e veta.

(Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim që mallrat e furnizuar të jenë conform standarteve dhe cilesise se kerkuar, si dhe i jep besueshmeri autoritetit kontraktor e produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës përmbushin standartet e kerkuara në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi, pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me aparaturë specifike të një natyre të vecante.

2.3.8 Kërkohe të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, të përfshihen specifikimet teknike për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit www.app.gov.al

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se : 6. “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose “ me qëllim që mallrat e furnizuar të jenë conform standarteve dhe cilesise se kerkuar, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të këtyre mallrave është një kërkesë e vendosur në kriteret e vecanta të kualifikimit, i shërben autoritetit për krijimin e një panorame të qartë mbi përpuethshmërinë e produktit/ëve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kerkuara nga autoriteti kontraktor.

Specifikime teknike për LOT 1 “Aparatura Okulistikë”

I- BIOMIKROSKOP

- Të mbulojë të gjithë aspektet e ekzaminimit të syrit
- Të sigurojë cilësi dhe qartësi në lidhje me imazhin
- Të garantojë komoditet në lidhje me përdorimin e pajisjes nga përdoruesi ndaj pacientit
- Të ketë mundësinë e azhurnimit më kamer në të ardhmen
- Të jetë i pajisur me mbajtësen e tonometrit të montueshëm
- Të ketë mundësinë e pozicionimit (horizontalisht/vertikalisht) nëpërmjet levës
- Të ketë të gjithë aksesoret e nevojshëm
- Blloku i ushqimit të funksionojë në 220 – 240V AC, 50 – 60 Hz
- Të jetë lehtësisht i dezinfektueshëm

Mikroskopi

- Të jetë mikroskop binokular konvergjues i tipit Galilean me konvergim deri në 6°
- Zgjedhja e shkallës së zmadhimit të realizohet nëpërmjet një rrotulle të komandueshme
- Të sigurojë shkallën e zmadhimit të paktën 10X, 16X, 25X
- Lentet të garantojnë zmadhimin okular të paktën 12.5 herë
- Diapazoni i rregullimit të syve të jetë minimalisht në rang nga -8D deri në +8D (D=Diopri)
- Rregullimi i distancës pupilare të jetë në rangun nga 50mm deri në 80mm me tolerancë +/-2

Njësia e ndriçimit

- Fusha e shikimit të jetë nga 5.7 deri në 41mm
- Këndi i hapjes së dritës të jetë minimalisht në diapazonin 0,5°; 10°; 15°; 20°
- Të ketë filtrate absorbues të nxehtësisë, të kuq, jeshil, gri, blu
- Të jetë me ndriçim LED minimalisht 280.000 Lux me rregullim të vazhdueshëm
- Temperatura e dritës jo më shumë se 3100 K
- Të ketë të paktën filtra RF(red free), blu (kobalt), neutral të densitetit
- Gjerësia e prerjes të jetë minimalisht në rangun 0 – 12mm dhe manovrueshme në mënyrë graduale
- Gjatësia e prerjes të jetë minimalisht në rangun 1 – 12 mm dhe e manovrueshme në mënyrë graduale
- Diametri i hapjes së diafragmës të jetë afërsisht 9,8,5,3,2,1,0.2mm
- Tendencja e prerjes të mundësohet me të paktën në 0 - 20° me hap jo më shumë se 5°

Bazamenti

- Gjatësia e lëvizjes së bazamentit para – prapa të jetë minimalisht 110mm
- Gjatësia e lëvizjes së bazamentit majtas – djathtas të jetë minimalisht 110mm
- Gjatësia e lëvizjes vertikale të jetë minimalisht 30mm
- Mbështetja e mjekrës
- Mbështetja e mjekrës të pozicionohet për afërsisht me 70mm vertikalisht
- Mbështetja e mjekrës të garantojë mbështetje ballore për pacientin

II- TONOMETËR APLANACIONI

- Të jetë i montueshëm në biomikroskop
- Të jetë i pajisur me mbajtësen për tu përshtatur me biomikroskopin
- Të kryejë matjen e tensionit intraokular në mënyrë të saktë
- Të ketë tolerancën brenda vlerave +/- 0.066KPa (0.5mmHg)
- Të jetë i pajisur me rregullator të shtypjes për një matje sa më precise
- Intervali i matjes nga 0 – 80 mmHg
- Deviacioni i matjes < 0.49mN
- Të mundësojë përzgjedhjen në lidhje me ekzaminimin e syrit të majtë apo të djathtë

III- B SCAN

- Aparaturë me ultratinguj për diagnostikimin e syrit
- Me ekran me ngjyra me prekje me kontrast të lartë minimalisht 13"
- E pajisur me sondë drejtimi magnetike të tipit B minimalisht 12KHz
- Të ketë opsione për të paraselektuar profilet për të optimizuar cilësinë e pamjes përfshirë parametra për orbitën, lëngun vitreoz, sipërfaqen e retinës si dhe brendësinë e retinës dhe korioidin
- Mënyra e skanimit të jetë të paktën me rreze 256, jo më pak se 2000 pika skanimi për çdo rreze minimalisht 500.000 pika skanimi për çdo matje
- Kontrolli i skanimit të jetë plotësisht i rregullueshëm në kohë, linjën bazale, për kalibrim në gjatësi dhe eksponenciale, si dhe të ofrojë mundësinë e modifikimit të shpejtësisë për sytë me vaj silikon
- Pozicionimi i skanimit të bëhet me selektim me prekje të pozicionimit aksial ose gjatësor me konfirmim të modelit të syrit
- Të mundësojë dhe të ruajë të paktën 50 video me deri në 20 prerje/sekondë për ekzaminim me cilësi të lartë duke mundësuar shtimin ose fshirjen e tyre, mundësimin e përgjigjes në kohë reale si dhe lëvizjet e ngadalësuara për imazh
- Të mundësojë ekzaminime të palimituara duke përdorur kompasin dhe matësit e këndit
- Të mundësojë përfshirjen automatike të parametrave të biometrisë B në formulat për llogaritjen e lentes intraokulare
- Të jetë i pajisur minimalisht me sistem operativ Windows 10, me një kapacitet të sistemit minimalisht 8GB DDR3 dhe memorje 500GB SSD.

VI – YAG/SLT LASER

- Duhet të jetë lazer okulistik me teknologjinë YAG/SLT për kapsulotominë, iridotominë dhe trabekuloplastinë selective
- Rrezja e goditjes duhet të jetë e kuqe minimalisht 635nm, me intensitet të rregullueshëm dhe energji të rrezes duke filluar nga 1.8mJ
- Shpejtësia e përsëritjes duhet të jetë deri në 3Hz
- Zmadhimi duhet të jetë i optimizuar për vizualizimin e përmirësuar të segmentit të parë
- Të jetë me ftohje me ajër

Për modalitetin YAG të ketë specifikimet si më poshtë:

- Duhet të ketë gjatësi vale infra të kuqe të paktën deri në 1064nm
- Të ketë energjinë nga 0.3 deri në 10mJ për pulsime, e vazhdueshme/e ndryshueshme (opsionale)
- Kohëzgjatja e pulsimit të jetë në diapazonin 0 – 4ns
- Shpejtësia e goditjes të jetë jo më pak se 3 shkrepje për sekondë për një shpejtësi dhe efikasitet trajtimi
- Modaliteti i goditjes të jetë i përzgjedhshëm për secilin impuls goditje 1, 2 dhe 3 impulse për goditje
- Madhësia e pikës së goditjes të jetë jo më e madhe se 8µm
- Këndi i konit duhet të jetë të paktën 16°
- Kompensimi (anterior dhe posterior) duhet të jetë 0 – 500 µm +/- 100 vazhdimisht e ndryshueshme

Për modalitetin SLT të ketë specifikimet si më poshtë:

- Duhet të ketë gjatësi vale jeshile të paktën deri në 532 nm
- Të ketë energjinë nga 0.3 deri në 2.5 mJ për pulsime, e vazhdueshme dhe e ndryshueshme
- Kohëzgjatja e pulsimit të jetë në diapazonin nga 0 – 3 ns
- Shpejtësia e goditjes të jetë i përzgjedhshëm për secilën goditje 1,2 dhe 3 impulse për goditje
- Madhësia e pikës së goditjes të jetë jo më e madhe se 400 µm
- Këndi i konit duhet të jetë $\leq 3^\circ$

- Duhet të përfshijë aksesoret standard si tavolina, ekrani i lëvizshëm, syzet e sigurisë, shenjat e sigurisë për lazer, mbulesë kundra pluhurit, lentet për iridektomi
- Të mundësojë përditësim me video kamer, modulën e asistentit, tonometër

V- TOPOGRAFI KORNEALE

- Aparatura për performimin e topografisë korneale, aberrometrisë korneale, me një kontroll të pozicionimit të syrit e kohë reale dhe ndalesa jo invasive
- Të jetë i lehtë e i transportueshëm
- Të funksionojë si aparaturë më vete ose të implementohet/përshtatet me Biomikroskopin
- Të jetë i pajisur me sistemin e kontrollimit të syrit për një efikasitet dhe përsëritshmëri të testimit pavarësisht kushteve të ndryshme
- Sipërfaqja e analizimit të jetë minimalisht 10mm x 14mm
- Koni i keratoskopit të jetë me të paktën 28 pika të shpërndara në mënyrë të barabartë në një sferë 43 Dioptri me të paktën 80.000 pika analizimi për një saktësi absolute
- Të ketë minimalisht 7000 pika matje për një mbulim korneal prej trashësisë 0.33mm deri në 11mm
- Të kryejë matjen e të paktën 90% të sipërfaqes korneale për syrin normal me një fuqi dioptrike nga 1 – 120 dioptri dhe rezolucion jo më pak se +/- 0.01D/micron
- Të jetë e pajisur me kamerë rezolucionit të lartë me një shkrepje automatike dhe korrektim të decentralizimit si dhe majën konike të lëvizshme nga 0° - 10°

Të jetë e pajisur me program për analizimin e parametrave si më poshtë:

- Shkalla dioptrike të jetë absolute, e normalizuar dhe e rregullueshme
- Vlerat keratometrike të kenë leximet e vlerave K, meridian, gjysëm meridian, treguesin Malonej, CLMI Keratokonus, dhe ndjekëse e keratokonusit (folloë-up)
- Pupilës ti qartësohet skaji, diametric dhe decentralizimi
- Zonat dhe sipërfaqet të jepen minimalisht në diametrat 3,5,7mm në akset karteziane dhe në vlera milimetrike.
- Të pasqyrohen në hartën kurvatura lokale, aksiale, dallgëzimi frontal OPD, gabimet e dallgëzimit dhe refleksionit, dhe harta e trashësisë me 3D
- Lëvizjet aksiale dhe pozicionimi i aksit të mundësohet minimalisht me verteksin korneal, pupilat, qendra ose çdo zgjedhje tjetër
- Të mundësojë minimalisht funksione si kontrolli i diferencave, i përsëritshmërisë, krahasim i hartave, kalibrim llogaritës i refleksionit

VI- LENTE OKULARE ME TRE PASQYRA

- Të jetë me aplikim universal
- Të jetë e pajisur me 3 pasqyra për ekzaminime të fundusit dhe të dhomës anterior
- Të ofrojë këndet e pasqyrave minimalisht me 60°, 65°, 75°
- Të ofrojë zmadhim të pamjes me të paktën 1.05herë
- Të ofrojë zmadhim të spotit të lazerit me të paktën 93herë
- Të ofrojë diametër kontakti me të paktën 15 mm
- Të shoqërohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm

TË TJERA

- Aparaturat të shoqërohen me manualët e përdorimit dhe servisit (User Manual & Service Manual) të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe
- Aparaturat të jenë të përshtatshme për rrjetin elektrik 220V – 240V/ 50 – 60 Hz
- Aparaturat të jenë të markuara me etiketën CE ose FDA me të dhënat teknike respektive

- Për aparaturat garancia të jetë jo më e vogël se 1 vit ku përfshihet mirëmbajtja, zëvendësimi i pajisjes ose i pjesëve të defektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, kjo e vërtetueshme me dokumentacionin përkatës të kompanisë prodhuese të aparaturave.
- OE duhet të kryejë instalimin, testimin, kalibrimin (në rastet kur është e nevojshme) dhe trajnimin e personelit për përdorimin e aparaturave.

Argumentim : Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 36 pika 1 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se :1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 pika 38/b të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e furnizimit të mallrave që do të prokurorhet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj si dhe me nenin 40 pika 2 të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës sipas shkresës nr.2837.prot date 03.08.2023 duke u bazuar në kërkesën e mjekeve okulist nr.5483.prot date 24.10.2022 në përputhje me mallin që prokurorhet në rastin aktual për aparaturë per okulistikën nuk janë diskriminuese dhe janë në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi.

Sasia

Artikulli	Përshkrimi	Sasia
1	Biomikroskop	1
2	Tonometër aplanacioni	1
3	B-scan	1
4	Yag / SLT Laser	1
5	Topografi Korneale	1
6	Lente Okulare me 3 pasqyra	1

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull

Afati I levrimit të mallit

Afati i lëvrimit të jetë 30 ditë kalendarike nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Argumentim : Afati për furnizimin e mallit 30 dite kalendarike është lene nga njesia duke u nisur nga praktikat e meparshme per procedura te ngjashme te zhvilluara nga vete AK

Njesia e prokurimit, referuar nenit 42 pika 5 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

2.Afati i fundit për pranimin e dokumentave dhe data e zhvillimit të tenderit, do të jete data 09.10.2023 ora 10.⁰⁰. Vendi www.app.gov.al; Spitali Fier.

(Mbeshtetur në pikën 5 të nenit 42 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. 5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.” si dhe duke pasur parasysh se shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-se behet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes në sistem të njoftimit, afati i vendosur nga NjP është brenda afatit ligjor perkates).

II. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOT. 2 “ Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: *Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të përlllogaritur për këtë lot

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Autoriteti kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si

dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/c

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministririt te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2022, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2023.*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së këtij loti.

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kriterëve të mësipërm e bën oferten të vlefshme

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" nenit 77 pika 4 ku përcaktohet se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; neni 40 pika 4 dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i*

ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Ne baze të VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40 pika 4 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara." dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës"

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me aparaturë mjekësore të një natyre të vecante

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese ose distributorin e autorizuar. Te plotësohet në shtojcën 2, Lista e cmimeve të artikujve ose të paraqesë një deklaratë mbi origjinën e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjinës).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi i mallit objekt prokurimi, pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me aparaturë mjekësore specifike dhe të një natyre të vecante.

2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësive. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën perkatese origjinale ose të perkthyer dhe të noterizuar. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH"

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", ku përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter është ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”. Gjithashtu ISO 9001: 2015 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise , specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, për një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përpunueshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative). Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Ne rastin aktual është vendosur konform objektit të prokurimit.

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikate CE ose FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të perkthyer dhe të noterizuara

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne funksion te cilesise së mallit te ofruar ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit ; piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit; nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor per garantimin e cilesise se mallit dhe për përmbushjen me sukses te kontrates . Gjithashtu ky kriter është vendosur per arsye se diektiva CE ose FDA (SHBA) jep kërkesat thelbësore që janë të zbatueshme për instrumentet, aparateve dhe pajisjeve, materialeve ose artikujve të tjerë që përdoren nga njerëzit me qëllim percaktimin e Diagnozes, parandalimit, monitorimit, kurimit apo lehtësimit zbutjes së sëmundjes, Diagnozes, monitorimit, kurimit apo lehtësimit, zbutjes apo kompensimit për një lëndim apo difekt, Hulumtimin, zëvendësim apo modifikim të anatomisë apo të procesit fiziologjik ne funksion te dhenies se nje sherbimi sa me cilesor ne funksion te jetes se pacientit. Gjithashtu ky kriter është hartuar ne baze te rekomandimit te Njesise se monitorimit prane APP-se ne procedurat e mëparshme te kryera nga AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. (Autorizimi duhet të jete I vlefshem).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet si dhe konform nenit 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”)

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese e mallrave ose nga Distributori i Autorizuar nga prodhuesi (distributori duhet të jete i autorizuar per territorin e Shqiperise) lidhur me tregtimin e artikujve te ofruar.Ne rastin e distributorit te autorizuar te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura specifike te nje natyre te vecante. Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatorin ekonomik ofertues.

2.3.7 Deklarate per permbushjen e afatit te garancise. Garancia jo me e vogel se nje vit ku perfshihet mirembajtja, zevendesimi i aparatures/pajisjes/mallit ose i pjeseve te defektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale te cilat do te sigurohen operatorin ekonomik fitues me shpenzimet e veta.

(Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur me qellim qe mallrat e furnizuar te jene conform standarteve dhe cilesise se kerkuar, si dhe i jep besueshmeri autoritetit kontraktor e produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës permbushin standartet e kerkuara ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura specifike te nje natyre te vecante.

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, të përfshihen specifikimet teknike për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit www.app.gov.al

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se : 6. “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose “ me qellim qe mallrat e furnizuar te jene conform standarteve dhe cilesise se kerkuar, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të këtyre mallrave eshte një kërkesë e vendosur në kriteret e vecanta të kualifikimit, i shërben autoritetit për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Specifikime Teknike per “ LOT 2 Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise ”

1) Poltrone për kemioterapi

- Poltrone elektrike për kimioterapi
- Poltrona të ketë të paktën 2 motorra për rregullimin elektronik të pjesës së shpinës, të këmbëve dhe pozicion trendelemburg

- Poltrona të jetë e veshur me lëkurë sintetike
- Struktura e mbuluar me material ABS
- Të jetë e pajisur me një njësi kontrolli (pult komandimi)
- Pjesa e krahëve të jetë e lëvizshme majtas-djathtas
- Të jetë e pajisur me rrota me frena me diametër të paktën 75 mm
- Përmasat: Gjerësi 90 – 100 cm, Gjatësi 165 – 175 cm, Lartësi 50 – 60 cm
- Këndi mbajtës i shpinës minimalisht 0° - 76° ose më mirë
- Këndi mbajtës i këmbëve të jetë minimalisht 0° - 40° ose më mirë
- Këndi trendelemburg të jetë minimalisht 0° - 10° ose më mirë
- Kapaciteti peshëmbajtjes të paktën 200kg

2) **Karroçë invalidësh**

- Karroçë invalidësh e palosshme
- Struktura duhet të jetë prej çeliku të kromuar ose konstrukcion alumini ose ekuivalent
- Duhet të ketë sistem frenimi të dy rrotat dhe mbështetëse të lëvizshme në pjesën e këmbëve
- Kapaciteti i mbajtjes të jo më pak se 150kg

3) **Karrel medikamentesh**

- Karreli për medikamente të jetë i pajisur me të paktën 2 sirtar
- Materiali duhet të jetë prej çeliku inoxi
- Karreli duhet të ketë strukturë sigurie në të paktën 3 anët e tij
- Të ketë 4 rrota me diametër 7.5cm – 10 cm, dy prej të cilave të jenë të pajisura me sistem frenimi
- Përmasat Gjerësi 40 – 50 cm x Thellësi 50 – 60 cm x Lartësi 80 – 90 cm

4) **Dollap medikamentesh**

- Dollapi të jetë i përshtatshëm për ruajtjen e medikamenteve
- Në pjesën e sipërme të jetë i pajisur me dyer prej xhami dhe me të paktën 2 rafte metalike me lartësi të rregullueshme
- Pjesa e poshtme me të paktën 2 sirtare dhe një dollap me dy Kanata
- Përmasat 180 – 185 cm x 90 – 95 cm x 31 – 36 cm

5) **Stativ serumi**

- Stativ inoxi me bazament minimalisht me 5 rrota
- I përbërë prej material çeliku inoxi
- Të jetë i pajisur me të paktën 2 grepa
- Me rregullim lartësie dhe me fiksues

6) **Shtrat ekzaminimi**

- Shtrat ekzaminimi i pajisur me 2 seksione
- Me përmasa të përafërta 180x57x73cm
- Të ketë 2 seksione nga të cilat pjesa e seksionit të kokës të jetë e lëvizshme
- Shtrati të jetë i pajisur me dyshek të veshur me material rezistent ndaj zjarrit dhe antibakterial

7) **Kape për citostatikët**

- Qëllimi i përdorimit : Për përgatitjen e citostatikëve, të jetë kapë e cila të mundësojë përpunimin e lëndëve toksike volatile dhe radionuklideve të përdorura në disa disiplina si mikrobiologji, virologji, hematologji, kultura qelizore, gjenetikë si dhe trajtim/përpunimin e agjentëve të rrezikshëm për njeriun

- Të funksionojë me qarkullim të ajrit me fluks laminar vertikal, në mënyrë që të ofrojë mbrojtje të trefishtë për operatorin, mjedisin dhe vetë produktin.
- Sistemi i shkarkimit të mundësojë përpunimin dhe shkarkimin e 100% të ajrit
- Të jetë i pajisur me ventilatorin kryesor të motorit dhe ventilator të integruar të shkarkimit
- Kapa dhe të gjithë aksesorët të jenë material çeliku të lyer me bojë epoksi me veshje antimikrobiale
- Kapa të jetë e pajisur me me dritare sigurie qelqi me lëvizje vertikale elektrike.
- E gjithë pjesa e brendshme e kapës të jetë me çelik inoksi
- Sistemi i ajrimit të sigurojë filtrim HEPA/ULPA në sipërfaqen e punës
- Të ketë mundësinë për tu pajisur me llampë germicidale UV
- Kapa të jetë me xham të temperuar me një kënd minimalisht 7° për të siguruar fushëpamje maksimale në dhomën e kapës
- Kapa të ketë një ndriçim të inkorporuar me tuba fluoreshente të cilat të japin një ndriçim jo më pak se 1200 Lumen në sipërfaqen e punës
- Dera të jetë me hapje elektrike
- Funksionet e kapës të jenë të kontrolluara me anë të mikroprocesorit
- Brenda dhomës së kapës të ketë të paktën 1 dalje elektrike me mbrojtje
- Përmasat e përafërta: Gjerësi 130 – 150 cm, Thellësi 85 – 90 cm, Lartësi 230 – 240 cm
- Filtrim me efikasitet mbi 99,995% MPPS për grimca me përmasa maksimalisht 0.3 mikron
- Të ketë funksionim silencioz me një nivel zhurme jo më të lartë se 60dB
- Kapa të jetë e pajisur me ekran LCD për afishimin e vazhdueshëm të parametrave që të mundësojë përzgjedhje të opsioneve dhe një tastierë të lehtë në përdorim.
- Të ketë alarme audio dhe vizive për këto funksione: fluksi i ajrit laminar jashtë parametrave të caktuar, pozicionim jo i duhur i dritares së xhamit, bllokim i filtrave HEPA/ULPA, keqfunksionim i motorrit të ventilatorit.
- Garancia e kapave dhe aksesorëve të jetë minimalisht 1 vit për çdo defekt të mundshëm. Instalimi, testimi, kalibrimet (në rast se është e nevojshme) si dhe trajnimi i personelit do të kryhet nga OE.

8) Tavolinë për përgatitjen e terapisë

- Tavolina për përgatitjen e terapisë me material çelik inoksi
- Të ketë minimalisht 1 raft në pjesën e poshtme
- Platforma e punës me mbrojtëse në pjesën fundore
- Dimensionet: 160 – 170 cm x 60 – 70 cm x 80 – 90 cm

9) Frigorifer profesional 4 – 8° C

- Volumi i frigoriferit nuk duhet të jetë më pak se 190 litra
 - Të jetë me dritë të brendshme
 - Frigoriferi duhet të ketë alarme për temperaturën dhe derën
 - Dera të jetë prej xhami i temperuar
 - Sipërfaqja e brendshme e frigoriferit duhet të jetë prej materiali plastik
 - Dimensionet 585 – 595 x 640 – 650 x 1425 – 1435 mm

10) Pompë infuzioni

- Pompë elastometrike për përdorim në kemioterapi
- Me volum të paktën 200ml
- Me peshë të vogël dhe e lehtë në përdorim
- Fluksi i rrjedhjes të paktën 2ml/h
- Saktësia +/- 15%
- DEHP dhe Latex Free

- Minimalisht 2 shtresa membrane silikoni. Kjo përmirëson saktësinë e rrjedhës dhe redukton mbetjet kur infuzioni përfundon
- Të ketë filtër të integruar për eliminimin e ajrit dhe grimcat e mëdha

11) Ndarëse poltronash

- Ndarëse e lëvizshme me rrota
- Të ketë 3 ndarje të palosshme afërsisht 50 x 170 cm secila
- Struktura metalike tubular
- Me perde plastike ose tekstili

TË TJERA

- Aparaturat : **Pompë infuzioni, kape për citostatikët** të shoqërohen me manualët e përdorimit dhe servisit (User Manual & Service Manual) të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe
- Aparaturat **Pompë infuzioni, kape për citostatikët** të jenë të përshtatshme për rrjetin elektrik 220V – 240V/ 50 – 60 Hz
- Aparaturat **Pompë infuzioni, kape për citostatikët** të jenë të markuara me etiketën CE ose FDA me të dhënat teknike respektive
- Për aparaturat **Pompë infuzioni, kape për citostatikët** garancia të jetë jo më e vogël se 1 vit ku përfshihet mirëmbajtja, zëvendësimi i pajisjes ose i pjesëve të defektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, kjo e vërtetueshme me dokumentacionin përkatës të kompanisë prodhuese të aparaturave.
- OE duhet të kryejë instalimin, testimin, kalibrimin (në rastet kur kërkohet) dhe trajnimin e personelit për përdorimin e aparaturave **pompë infuzioni, kape për citostatikët**.
- Garancia e **poltronave, shtretërve të ekzaminimit, frigoriferit profesional, ndarëseve të poltronave etj të jetë jo më pak se 1 vit, ku të përfshihet mirëmbajtja, zëvendësimi i pajisjes ose pjesëve të defektuara me të reja dhe origjinale.**

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes sipas shkreses nr.2836.prot date 03.08.2023 dhe janë konform *nenit 40 pika 2 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe janë vendosur nga specialistet e fushes ne perputhje me mallin qe prokurohet ne rastin aktual per pajisjet mjekesore jane percaktuar nga specialistet e fushes, nuk jane diskriminuese dhe jane ne perputhje me legjislacionin aktual ne fuqi.*

Argumentim : *Specifikimet teknike janë vendosur ne perputhje me nenin 36 pika 1 te ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku percaktohet se :1. Specifikimet teknike, siç percaktohen në nenin 4 pika 38/b të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike percaktohen qartë karakteristikat e furnizimit te mallrave që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj si dhe me nenin 40 pika 2 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, janë hartuar nga specialistet e fushes duke u bazuar ne kerkesat e mjekeve te klinikes se kemioterapise nr.3512.prot date 19.07.2022 dhe nr.4131.prot, date 26.08.2023, kerkeses se specialistes se sektorit te hotelerise nr.3503.prot date 19.07.2023 dhe kerkeses nr.3503/1, date 19.07.2023 te sektorit te Menaxhimit te Teknologjise ne perputhje me mallin qe prokurohet ne rastin aktual per poltrone aparatura etj per punktun e kemioterapise nuk jane diskriminuese dhe jane ne perputhje me legjislacionin aktual ne fuqi.*

Sasia

Artikulli	Përshkrimi	Sasia
1	Poltrone kimioterapie	11
2	Karroce invalidi	5
3	Karrel medikamentesh	10
4	Dollap medikamentesh	2
5	Statik serumi	15
6	Shtrat ekzaminimi	2
7	Kape per citostatike	1
8	Tavoline per përgatitjen e terapise	2
9	Frigorifer profesional (4-8 ° C)	1
10	Pompe infuzioni	50
11	Ndarese poltronesh	10

Afati I levrimit te mallit

Afati i levrimit të jetë 30 ditë kalendarike nga momenti i nënshkrimit të kontrates

Argumentim : Afati per furnizimin e mallit 30 dite kalendarike eshte lene nga njesia duke u nisur nga praktikat e meparshme per procedura te ngjashme te zhvilluara nga vete AK

Njesia e prokurimit, referuar nenit 42 pika 5 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

2.Afati i fundit për pranimin e dokumentave dhe data e zhvillimit të tenderit, do të jete data 09.10.2023 ora 10.⁰⁰. Vendi www.app.gov.al; Spitali Fier.

(Mbeshtetur ne piken 5 te nenit 42 te ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". 5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë." si dhe duke pasur parasysh se shpallja e njoftimit të kontrates ne faqen e internetit te APP-se behet publike ditën e nesërme te punes nga dita e hedhjes ne sistem te njoftimit, afati i vendosur nga NjP eshte brenda afatit ligjor perkates).

NJESIA E PROKURIMIT